

AKTI I THEMELIMIT

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar Fagma Construction

Neni 1: Themeluesi

1.1. Emri: Fatmir Allmuça, shtetas shqiptar, I dtl.25.09.1957, i biri Fadil-it lindur ne Mumajes,Tirane e banues ne Tirane, i pajisur me Karte Identiteti Nr.036057062, Nr.personal F70925014T.

1.2. Adresa: Rruga Myrteza Këlliçi, Pallati Al-Fam, Njësia Administrative nr.2, Apartamenti Nr.33,Tirane.

Neni 2: Emërtimi dhe Forma Juridike

2.1. Emri i Shoqërisë: Fagma Construction

2.2. Forma Juridike: Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k)

Neni 3: Selia

3.1. Selia e Shoqërisë: Tirane, Njësia Bashkiake nr.2, rruga Myrteza Këlliçi, zona kadastrale 8150, nr.pasurie 6/551, 6/553, 6/172, 6/173

Neni 4: Kohëzgjatja

4.1. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.

Neni 5: Kapitali

5.1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100,000 Lekë, i ndarë në 1 kuotë të vetme.

5.2. Ortak i vetëm dhe zotërues i 100% të kapitalit të Shoqërisë është Fatmir Allmuça.

Neni 6: Administratori

6.1. Me këtë akt emërohet Administrator i Shoqërisë: Z. Adlens Allmuça, shtetas shqiptar, I dtl.15.05.1983, i biri Fatmir-it lindur e banues ne Tirane, i pajisur me Karte Identiteti Nr.035243800, Nr.personal I30515177F, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

6.2. Administratori ushtron kompetencat në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

6.3. Administratori emërohet për një periudhë 3 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 7: Objekti i Veprimtarisë

7.1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë përfshin:

- Projektim në ndërtim, studime plane racionale urbanistike, plan rregullues për qendra të banuara, qytete, studime urbanistike, studime pjesore urbanistike, projektme objekte

civile, industriale, turistike deri pesë kate, projektme objekte civile, industriale, turistike mbi pesë kate, projektme objekte sportive, projektme interfier, projektim pejsazhesh, sistemime sipërfaqe të gjelbra lulishte, furnizim me ujë, kolektorë shkarkimi, ujësjellësa, kanalizime urbane dhe rurale, rrugë auto të kategorisë V dhe IV, projektim shtresa rrugore dhe sistemim asfaltim, projektim ura dhe vepra arti mbi 10 m.

- Zbatim në ndërtim, gjurmime dheu në punime eventuale, muraturë dhe beton armë, prishje dhe në tokë të gjermuar, ndërtime civile industriale, turistike dhe bujqësore deri pesë kate, ndërtime civile industriale, turistike dhe bujqësore mbi 10 kate, rikonstruksione, ndërtim banese me skelet mbi 10 kate, ndërtim rrugë të kategorisë IV dhe V, ndërtim rrugë të kategorisë III, II, I, punime të mirëmbajtjes dhe sinjalistikës në rrugë, ndërtim mbishtresa rrugore, ndërtim autostrada, pista aeroporte, heliporte, ndërtim tunele rrugore dhe hekurudhore dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to.
- Ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m, kaskada, ura metalike dhe të varura.
- Ndërtim ujësjellësa, kanalizime, kanale dhe impiante vaditëse.
- Prodhim materialesh ndërtimi, prodhim materiale inerte lumore dhe malore (konglomerate), gurë gëlqerorë nga guoret malore, prodhime elemente betoni dhe beton armë të zakonshëm dhe të parandëruar, gurë dekorativë, prodhim materiale lidhëse, gëlqere, çimento, allçi, betone, prodhime me bazë bitumi dhe sintetike.
- Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport të materialeve ushqimore, industriale, lëndë të para, makineri dhe pajisje, automjete të transportit urban dhe të mallrave, makineri teknologjike ndërtimi gjysëm të gatshme, produkte, artikuj të konsumit farmaceutik, elektro-shtëpiake, konfeksione, bimë medicinale, kozmetike, prodhim dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, pjesë këmbimi për makineri të ndryshme, makineri dhe automjete, pika servisi, tregtim karburantesh dhe vajra lubrifikante, hapje dyqane, bar bufe, restorant, hoteleri, përdorimi i lëndëve plasëse dhe shpërthyes për nevoja civile, shpërthim në guore për prodhim materialesh inerte, për përdorime në gjurmime të natyrave të ndryshme.
- Kërkime dhe zbulime në fushën minerare, përfshirë edhe hidrokarburet, nxjerrje, përpunime dhe tregtim, eksportim.
- Menaxhim i mbetjeve, grumbullim dhe transportim i mbetjeve inerte, mbetjeve rrugore, stacion transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme.

Neni 8: Dispozita të Fundit

8.1. Ky akt themelimi hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe regjistrimit të tij në Regjistrin Tregtar.

8.2. Për çështjet që nuk janë të rregulluara në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Tirane, 07.08.2024

Fatmir Allmuça

